



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01- 12856/20  
Kaçanik, 24.06.2020

## PROCES VERBAL

Nga mbledhja e IV-të (Katërt) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24 Qershori 2020. Për shkak të distancës fizike, mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës – Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive; Bahri Selimi, Ukshin Qallaku, Fatmir Loku, Zahir Doda, Ramadush Osmani dhe Festim Neziraj, ndërkaq nga zyrtarët komunal ishte, Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IV-të (Katërt) të Rregullt të KPF-a për vitin 2020, data 24 Qershori, me këtë:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Drafti për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës të Komunës;
3. Draft- Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet 2021-2023;
4. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për N.K.P “Stacioni i Autobusëve” SH.A. - Kaçanik;
5. Propozim Vendim për rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020;
6. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private të Mustafë Lama, për ndërtimin e rrugës në Kaçanik të Vjetër; dhe
7. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit është njëzëri me punuar me këtë rend pune. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF, e,

#### APROVOJ

#### **Rendin e propozuar të punës, në përbërje 7 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

#### APROVOJ

**Procesverbalin e mbledhës së III-të (Tretë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 21 Maj 2020 / Lënda: 01Nr. 060/01- 9769/20.**

2. Drafti për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Materialin e keni marrë, për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DAP, Festim Neziraj, njëherë edhe Kryetar i Komisionit për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës.

**z. Festim Neziraj**, Drafti është ai i cili është hartuar qysh herët nga komisioni dhe i njëjti e ka marrë miratimin në KPF, ndërsa që nuk ka pasur vullnet për aprovimin e tij nga subjektet politike të përfaqësuara në KK. Mendimi im është së janë plotësuar të gjitha kushtet me u ndryshuar dhe plotësuar Statuti i Komunës, pasi që është nevojë me u bërë këto ndryshime dhe jemi e vetmja komunë që nuk e kemi ndryshuar statutin e komunës nga koha kur është aprovuar, nga viti 2008.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçiku**, Vërejtjet e mia janë; Ky draft statut vjen pas 2 viteve në shqyrtim në kuvend, me çka kujtoj së drafti në fjalë bien ndeshë me Udhëzimin Administrativ për transparencë në komuna 01/2015, sepse në UA shënohet që aktet e komunës i nënshtrohen procedurës së debatit publik me qytetarë, përfshirë edhe debatet në zona rurale. Gjithashtu draft statuti është në kundërshtim edhe me Rregulloren 01.2017 të MAPL për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve në komuna, për arsyen Zyra për integrime Evropiane duhet të bëjë harmonizimin e akteve të komunës me rregullat e Bashkësisë Evropiane, dhe konfirmime të tjera të përcaktuara si në rregullore. Duke u nisur nga këto që i potencova, mendoj se çështja e ndryshim plotësimit të Statutit të komunës duhet të kthehet në pikën 0.

**z. Selim Reka**, Nga komisioni i KK për ndryshim plotësimin e Statutit të komunës është bërë në punë e mirë në draftimin e ndryshimeve të statutit të komunës. Unë jam për me u bërë ndryshimet e propozuara me përjashtim të, rritjes së numrit të drejtorive komunale. Disponimi politik nuk është përritjen e numrit të drejtorive komunale, ndërsa që përfshim plotësimet tjera të propozuara jam për atë që të aprovohen.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Statuti i Komunës ka nevojë të ndryshohet dhe plotësohet për shkak së kemi nene e paragrafë që bien në kundërshtim me LVL. Unë nuk jam që kjo çështje të kthehet në pikën 0, kur dihet se komisioni i formuar i KK ka bërë një punë mjaftë të mirë dhe komisioni ka qenë i përfaqësuar nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në KK. Të çështja e pëlqimit politik, shtimi i drejtive po bëhet për një funksionim më të mirë të komunës, kështu që Statuti është nevojë të ndryshohet dhe plotësohet në mënyrë që të jetë i gatshëm, pavarësisht kush vjen në pushtet.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi**, Edhe unë i bashkëngjitëm diskutimit të Kryesuesit të KK që çështja e Statutit të Komunës mos me rënë në pikën 0 që e tha z. Ekrem Kyçyku pasi që komisioni që ka punuar në këtë draft statut ka qenë i përfaqësuar nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në KK. Ne jemi komuna që kemi më së paku drejtori, ndërkaq dihet volumi i punëve, si fjala vjen të DAK. Drafti është propozuar, ndërkaq e drejta e juaj është me vendosur. Unë nuk jam që draft të votohet nen për nenin, por si tërësi. Është hera e tretë që tentojmë me ndryshuar statutin e komunës, ndërkaq ndryshimet nuk po e bëjmë për veti, pasi mandati i kësaj legislature është edhe 1 vit, kështu që, kushdo që fiton zgjedhjet e ka statutin të gatshëm me funksionuar komuna në bazë të tij.

**z. Ekrem Kyçyku**, Draft Statuti bien ndeshë më UA 2015.01 dhe më Rregulloren për harmonizimin dhe publikimin e akteve në komuna 01/2017, kështu që i njëjtë duhet të harmonizohet me dispozitat e këtyre dy akteve ligjore.

**z. Festim Neziraj-** Unë jam konsultuar me Zyrën ligjore, gjendja juridike nuk ka ndryshuar, kërkesat e ekzekutivit dhe të OJQ-ve janë të njëjta. Se a është akti në rregull apo jo, këtë e konstaton dhe e vërteton MAPL. Ne po besojmë se është në rregull me aktet të cilat u përmenden, drafti kur është hartuar i ka pasur konfirmimet e të gjitha njësive që u përmenden dhe ato dokumente ekzistojnë. Nga ana procedurale është krejt në rregull. Debatet publike me qytetarë janë mbajtur dhe besoj se jemi krejt në rregull sa i përket anës procedurale.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, kështu që ajeni të pajtimit që kjo çështje t'i adresohet KK për shqyrtim dhe aprovim; Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Drafti për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës të Komunës; të njëjtën ia  
Rekomandon  
Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

3. Draft- Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet 2021-2023;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Drafti i jep orientimet për buxhetin e planifikuar për tre vite dhe shpenzimet. Drafti është në procedurën fillestare, pasiqë i njëjti shkon në procedure të debatit publik me qytetarë të komunës. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Pjesa përshkruese disa gabime janë hequr, ndërkaq ka ende të dhëna të cilat nuk qëndrojnë, si Lypetenit nuk është maja me lartë në Kosovë dhe disa gabime të tjera në përshkrim. Të buxheti i vitit 2021 nuk ka çerdhe të planifikuara e as terrene sportive, ka planifikime për trotuare, ndërkaq nevojat e qytetarëve të komunës janë për ujësjellës dhe

kanalizim janë të mëdha, kështu që është dashur më prioritet më qenë, investime në realizimin e këtyre projekteve që i potencova.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Të pjesa e DSHPE, nuk figuron rruga projekt i rrugës: Dallosh-Cen –Doganaj, i cili projekt është lënë në gjysmë.

**z. Ramadush Osmani**, Të ky projekt i rrugës që e potencoj Kryesuesi i Kuvendit, është bërë një gabim teknik.

**z. Selim Reka**, Drafti kornizë janë dhënë orientimet e buxhetit për 3 vite, ndërkaq ka vend për kritikë të prioriteteve: Kur jemi të projektet kapitale, ne duhet shikuar se cilat projekte janë më prioritet në mënyrë që me i futur në listë, ndërkaq me i hequr ato që janë me pak me prioritet karshi projekteve me prioritet. Unë nuk kam hyrë në analiza, ndërkaq dihet së prioritet i prioriteteve është uji i pajes. Këtij projekt duhet me i dhënë përparësi e me bërë zgjidhje, pastaj me kaluar në prioritetet tjera.

**z. Nexhat Loku**, Në f. 25 të dokumentit, Pagat jubilare sipas kontratës kolektive për arsim me kosto 1.1 milion euro, me duket se është shumë e madhe e mjeteve buxhetore të ky pozicion.

**z. Bahri Selimi**, Të çështja e Pagave jubilare sipas kontratës kolektive për arsim me kosto 1.1 milion euro, kjo shumë është në nivel të përgjithshëm të Kosovës. Në vazhdim drejtori Selimi dha edhe sqarime të tjera lidhur me kornizën buxhetore, listën e projekteve kapitale e cila listë u shpërndanë në mbledhje për shkak së e njëjtë ka pësuar disa ndryshime, me atë që është dërguar së bashku me draftin kornizë.

**Kryetari i Komunës, Besim Ilazi**, Të çështja e përshkrimit të Komunës së Kaçanikut të cilën e potencoj z. Ekrem Kyçyku, gabimet teknike si të gabimet e lëshuara për Majën e Lypetenit është çështje teknike, këto mund të përmirësohen. Projektet e propozuara janë dhënë si ide, ndërkaq Korniza buxhetor ka edhe procedurat e Debatit publik me qytetarë. Ku aty mund të merrni pjesë dhe i jepni propozimet e juaja. Të çështja e ujit të pajes, kompetencat për ujësjellës i kanë kaluar ministrisë, kështu që çdo kush që ka ndikim në qeveri, duhet marrë veprime për nxjerrjen e ndonjë projekti të ujit nga ministria. Ne, çdo herë kemi kërkuar projekt të ujësjellësit nga kompania regionale, por nuk kemi marrë ndonjë konfirmim. Ne, si komunë e kemi të pamundur pa donacione dhe fond të nivelit qendror me bërë ndonjë zgjidhje për çështjen e projektit të ujësjellësit, sepse dihet buxheti i komunës tonë. Unë kërkoj nga ju t'i jepni propozimet, në mënyrë që të dimë se cilit projekt t'i japim më tepër prioritet.

**z. Selim Reka**, Kërkoj sqarime të nevojshme për projektin, Rregullimi i fazës së i të projektit "Rregullimi dhe ndërtimi i Qarshisë së vjetër të qytetit".

**Kryetari i Komunës**, Është ide me u ndërtuar Qarshia e qytetit të Çerdhja e fëmijëve. Këtë ide do e prezantojmë edhe në Debatin publik të organizuar me qytetarë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Draft Kornizë e shtroj në votim për aprovim me ia kaluar Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim dhe e njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Draft- Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut për vitet 2021-2023;  
dhe e njëjtë i ,**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**4. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për N.K.P “Stacioni i Autobusëve” SH.A. - Kaçanik;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani.

**z. Ramadush Osmani,** Për shkak të virusit Covid-19, ndërmarrja N.K.P “Stacioni i Autobusëve” nuk ka pasur inksim të hyrave nga peronizimi, pasi që peronizimi është liruar nga pagesa e taksave, kështu që punëtorët e Stacionit të autobusëve kanë ngelur pa paga. Kërkesa e tyre është më i mbështetur me mjete buxhetore dhe një përkrahje e tillë simbolike, besoj se iu bënë zgjidhje.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ka pasur kërkesa me i liruar nga peronimi deri në muajin shtator, sepse nuk kanë pasur udhëtarë për me mbuluar peronimin. Është mirë me bërë kalkulime dhe me i liruar nga peronimi deri në muajin shtator të gjitha kompanitë që veprojnë në stacionin e autobusëve.

**z. Ramadush Osmani,** Të hyrat nga peronimi për një javë janë 1000€.

**z. Bahri Selimi,** Ne, është mirë me i bërë kérkesë ministrisë me i futur në pako emergjente, sepse ndonjë mundësi më të mirë tjetër nuk kemi me mbështetur Stacionin e Autobusëve.

**z. Selim Reka,** A ka mundësi të ndihmohet me mjetet buxhetore të cilat janë ndarë për menaxhimin e situatës së pandemisë Covid-19.

**Kryetari i Komunës,** Nëse ne e ndihmojmë një kompani me mjetet buxhetore të ndara për menaxhimin e pandemisë Covid-19, atëherë mund të krijojmë pakënaqësi të ndërmarrjet tjera, kështu që vetëm sa krijojmë pakënaqësi të bizneset tjera.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim me ia kaluar Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim dhe e njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e. Në saje të kësaj del konstatimi së, KPF e,

**Aprovoj**

**Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 1.000.00€ (njëmijë euro) për N.K.P “Stacioni i Autobusëve” SH.A. - Kaçanik; dhe i njëjtë i ,**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**5. Propozim Vendim për rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diłka në këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Propozim Vendim për rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020 dhe i njëjti i ,**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**6. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private të Mustafë Lama, për ndërtimin e rrugës në Kaçanik të Vjetër;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diłka e hapi diskutimin:

**z. Nexhat Loku,** U interesua me ditur për pronat që këmbehen, në cilën pjesë gjenden.

**Kryetari i Komunës,** Sqaroj për pronat që këmbehen së ku gjenden, pronat në fjalë gjenden të pjesa e rrugës Kaçanik i Vjetër – Begracë. Raporti ka qenë  $\frac{1}{4}$  me u këmbyer pronat kur është shtruar rruga. Lënda është në gjykatë. Ne e kemi një prone përafërsisht 8 ari që lidhet me pronat e pronarit, të cilën pala ka pranuar me marrë dhe me i dhënë 28 ari. Mustafë Lama me këtë këmbim është zotuar së nëse realizohet, do të térheqë padinë nga gjykata.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Propozim Vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën private të Mustafë Lama, për ndërtimin e rrugës në Kaçanik të Vjetër; dhe i njëjti i**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**7. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nga z. Kijani Sallahu e kam një shkresë sipas të cilën administratorët e fshatrave kanë marrë derivate 50 litra e jo 50€. Besoj së këtu është bërë ndonjë gabim teknik dhe i njëjti duhet të rregullohet në raport. Për me arsyetuar këtë raport, fjalën e ka Kryetari i Komunës, njëherë edhe Kryetar i Shtabit Emergjent. Besim Ilazi

**Kryetari i Komunës- Besim Ilzai,** Në raport është përfshirë aktiviteti i Shtabit Emergjent lidhur me menaxhimin e situatës së pandemisë Covid-19. Të çështja e administratorëve, sigurisht është bërë ndonjë gabim teknik, sepse kanë marrë nga 50 litra derivate e jo mjete buxhetore kesh. Në vazhdim Kryetari Ilazi raportoj për numrin e takimeve të këtij shtabi, rekomandimet e dala nga këto mbledhje dhe aktivitetin tjetër të përgjithshëm të mekanizmave relevantë për menaxhimin e pandemisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Selim Reka**, Nga raporti shihet së Shtabi Emergjent ka bërë një punë të madhe në aktivitetin e tij për menaxhimit të gjendjes së pandemisë Covid-19. Në komunën tonë kemi qenë më fat që nuk ka pasur shumë të infektuar, shpresoj gjendja e pandemisë mos të përsëritet. Ka pasur shumë raste që kanë ndier nevojë me iu ndihmuar me pako ushqimore etj. dhe është mirë që Shtabi emergjent është mobilizuar dhe iu ka ardhur në ndihmë familjeve në nevojë, për këtë iu shprehim mirënjojje.

**z. Ekrem Kyçiku**, Prej ministrisë së Shëndetësisë sa e kam informacione unë, komuna jonë është furnizuar me pajisje të nevojshme (maska mbrojtëse, dorëza etj.) për menaxhimin e pandemisë Covid -19, ndërkaq në raport shënohet se jemi furnizuар shumë pak me këto lloje pajisjesh.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi**, Nga MSH shumë pak jemi furnizuar me një shumë simbolike të dorëzave etj. dhe kam më të dërguar të dhënat lidhur me të gjitha furnizimet që i kemi pasur nga ministria.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Raporti nuk votohet, kështu që konstatoj së, KPF u,  
**Njoftua**

**Me Raportin e Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut dhe i njëjti i kalohet Kuvendit të Komunës për njoftim.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:25. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët.

Mbledhja e Kuvendit të Komunës është caktuar për datë, 30 Qershor 2020, në ora 11:00.

Procesmbajtës  
Makfise Malsiu  
*JYU Malisi*

